



KOMUNA KLINË

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

10 Nr.prot. MM-20226 /2026

Klinë, 14.07.2026

Në kuadër të manifestimit tradicional letrar "Ora e Tahir Deskut", që mbahet më 7 shtator për nder të datëlindjes së shkrimtarit- poetit të shquar, gazetarit e reporterit të luftës Tahir Deskut, Komuna e Klinës - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS LETRAR



Për çmimin tradicional vjetor "ORA E TAHIR DESKUT" për veprën më të mirë letrare të botuar në mes dy manifestimeve letrare si dhe çmime për tri poezitë më të mira konkurruese.

Kushtet për konkurrim:

- Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë krijuesit letrarë nga të gjitha trojet shqiptare.
- Konkurrimi hapet nga data e shpalljes së konkursit, pra nga 14 korrik deri më 14 gusht 2026.
- Konkurrimi bëhet përmes nominimeve të institucioneve, shoqatave e asociacioneve letrare të regjistruara në Kosovë dhe individualisht.
- Vepra të ketë vlera letrare-artistike dhe të jetë në përputhje me Rregulloren e manifestimit letrar.
- Konkurruesit letrarë duhet të sjellin në zyrat e DKRS-së nga tre (3) ekzemplarë për çdo libër.
- Çmimi letrar "TAHIR DESKU" vlerësohet me mirënjohje dhe vlerë monetare me 500 € .

Përveç çmimit tradicional, mbahet gjithashtu "Ora letrare e poezisë" në kuadër të së cilës interpretohen poezitë konkurruese dhe vlerësohen nga juria profesionale.

- Poezitë konkurruese duhet të jenë të autorëve konkurrues dhe të pabotuara.
- Një autor ka të drejtë të konkurrojë vetëm me një poezi.
- Poezitë dërgohen në formatin Word dhe ju vendosen kode shifrore nga organizatori.
- Juria profesionale do të bëjë përzgjedhjen e 20 poezive pjesëmarrëse në konkurrencë, pastaj ndër to t'i vlerësoj tri më të mirat të cilat vlerësohen me:
 - Vendi i parë – mirënjohje dhe 100 €;
 - Vendi i dytë – mirënjohje dhe 70 €
 - Vendi i tretë – mirënjohje dhe 50 €
 - Gjithashtu ndahen edhe mirënjohje për pjesëmarrësit në orën letrare.

Kemi nderin të ftojme krijuesit letrarë të bëhen pjesë e këtij konkursi dhe të madhështojnë përkujtimin për shkrimtarin dhe gazetarin e shquar Tahir Desku.

- Aplikimi për veprën letrare dhe çmimin “Ora e Tahir Deskut” bëhet përmes nominimeve të lartcekura dhe fizikisht në zyrat e DKRS-së, ndërsa
- Poetët lutën që poezitë e tyre t'i dërgojnë në këtë email: alban.gashi@rks-gov.net
- Poetët e poezive që përzgjidhen për konkurrim do të njoftohen përmes email-it.

Konkursi mbetet i hapur deri më 14 gusht ndërsa juria shpall rezultatet më 7 shtator 2026, ditën e manifestimit letrar **“ORA E TAHIR DESKUT”** që mbahet në këtë vit.

Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport
Lorenc Marku

